



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 208 Nr. i faq./Br.str/No.pg 1

Data/Datum/Date 07.06.2021

Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dhe nenit 92 paragrafi 1, nenit 17,18,19,20,21 dhe 22 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2021 si dhe nenit 6 pika 1.2 Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna kryesuesi i Kuvendit Komunal të Rahovecit në bashkëpunim me Zyrën për Informim organizon:

**Njoftim
Konsultim Publik**

Qytetarë të nderuar të komunës së Rahovecit, ju ftojme të merrni pjesë në **KONSULTIMIN** Publik për Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues 2022. Ky konsultim publik, organizohet nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Zyra Për Informim.

Konsultimi Publik do të mbahet me **25.06.2021** (e premte) në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit me fillim në ora **10:00**. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit.

Në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/05/Qarkorja-2022-01-SHQ.pdf>, mund të gjeni Qarkoren e parë Buxhetore 2022-2024.

Jeni të mirëseardhur!

**01 Nr. 205/21
Rahovec: 10.06.2021**

